

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-095/12

Prishtinë 17 janar 2012

Në çështjen juridike të:

H. V.
P.

Pala ankuese

kundër

M. J.
M 55
34000 K
S

Paraqitësi i kërkesës/ Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/119/2011 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat KPA24978, KPA24981, KPA24985, KPA24986, KPA24987 dhe KPA24988), të datës 7 shtator 2011, KKPK /D/A/19/2008 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA24979), të datës 20 qershor 2008, dhe KKPK /D/R/21/2008 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA24980), të datës 20 qershor 2008, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 janar 2012, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Ankesa e H V kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/19/2008, e datës 20 qershor 2008, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA24979 hidhet si e palejueshme.

- 2- Ankesa e H V kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK /D/R/21/2008 të datës 20 qershor 2008 dhe kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK /D/A/119/2011 të datës 7 shtator 2011 refuzohet si e pabazuar.

- 3- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/R/21/2008 i datës 20 qershor 2008, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA24980 dhe vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/119/2011 i datës 7 shtator 2011 sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrat KPA24978, KPA24981, KPA24985, KPA24986, KPA24887 dhe KPA24988.

- 4- Pala ankuese duhet t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 55 (pesëdhjetë e pesë) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 1 mars 2007, M J në cilësinë e tij si anëtar i familjes së bartësit të së drejtës pronësore paraqiti tetë kërkesa pranë Agjencionit Kosovar të Pronave (AKP), duke kërkuar konfirmimin e të drejtave pronësore, ri-posedimin dhe kompensimin për shfrytëzim të paautorizuar. Ai shpjegoi se i ati i tij i ndjerë kishte qenë pronar i pasurive dhe se i kishin humbur ato më 13 qershor 1999 dhe se humbja ka qenë rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë.

Të dhënat e ngastrave të kërkuara, të gjitha të regjistruara në Fletën Poseduese nr. 29 të Podujevës, zona kadastrale Bajqinë, e lëshuar më 25 dhjetor 2001, janë si në vijim:

Numri i ankesës dhe dosjes në AKP	Të dhënat e ngastrave
GSK-KPA-A-095/12 (KPA24978)	Ngastra nr. 1063, te vendi i quajtur “Zharina”, livadh i klasit 5 me sipërfaqe prej 12 ari dhe 7 m ² ;
GSK-KPA-A-096/12 (KPA24979)	Ngastra nr. 1072, te vendi i quajtur “Zharina-Dvorishte”, livadh i klasit 4 me sipërfaqe prej 3 ari dhe 40 m ² ;
GSK-KPA-A-097/12 (KPA24980)	Ngastra nr. 1072, te vendi i quajtur “Zharina-Dvorishte”, një shtëpi (e shkatërruar) me sipërfaqe prej 63 m ² dhe me një tokë përcjellëse me sipërfaqe prej 5 ari;
GSK-KPA-A-098/12 (KPA24981)	Ngastra nr. 1073, te vendi i quajtur “Zharina-Zharina”, një kopsht pemësh i klasit 3 me sipërfaqe prej 8 ari dhe 58 m ² ;
GSK-KPA-A-099/12 (KPA24985)	Ngastra nr. 1319, te vendi i quajtur “Zharina-Rushulak”, një kopsht pemësh i klasit 2 me sipërfaqe prej 1 ari dhe 60 m ² ;
GSK-KPA-A-100/12 (KPA24986)	Ngastra nr. 1326, te vendi i quajtur “Zharina-Rushulak”, një kopsht i klasit 2 me sipërfaqe prej 4 ari dhe 19 m ² ;
GSK-KPA-A-101/12 (KPA24987)	Ngastra nr. 1330, te vendi i quajtur “Zharina-Rushulak”, fushë e klasit 3 me sipërfaqe prej 7 ari dhe 83 m ² ;
GSK-KPA-A-102/12 (KPA24988)	Ngastra nr. 1335 te vendi i quajtur “Zharina-Rushulak”, tokë djerrinë me sipërfaqe prej 3 ari dhe 39 m ² ;

Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës dorëzoi pranë AKP-së dokumentet vijuese:

- Kopjen e Fletës Poseduese Nr. 29 lëshuar nga Republika e Serbisë, Qendra për Kadastër dhe Pronë të Patundshme Prishtinë, Departamenti për Patundshmëri dhe Kadastër Podujevë për Komunën e Podujevës, Komuna Kadastrale Bajqinë, më 25 dhjetor 2001, që tregon se prona e kontestuar ishte regjistruar për Jovanović S M, Bajqinë;
- Çertifikatën e lindjes të lëshuar nga Republika e Serbisë për Komunën e Podujevës në Niš më 13 janar 2005, që tregon se paraqitësi i kërkesës është lindur në Bajqinë si i biri i M J;
- Çertifikatën e vdekjes të lëshuar nga Republika e Serbisë për Komunën e Zemunit në Beograd më 15 janar 2007, që tregon se M J kishte vdekur më 12 tetor 1990;

AKP ka arritur ta vërtetojë Fletën Poseduese nr. 29 meqë ka gjetur Fletën Poseduese nr. 29 lëshuar nga UNMIK-u më 20 nëntor 2007, që tregonte se prona ishte regjistruar në emër të M (S) J.

Në vitin 2007 dhe 2008, zyrtarët e AKP-së shkuan në vendin ku pretendohet se ndodheshin ngastrat dhe vendosën shenja që tregojnë se prona është objekt i një kërkesë dhe se palët e interesuara është dashur t'i paraqesin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve.

Pasi që askush nuk u përgjigj, KKPK i trajtoi lëndët si të pakontestuara dhe me vendimin e vet KKPK/D/A/19/2008 të datës 20 qershor 2008 aprovoi kërkesën në lëndët KPA24978, KPA24979, KPA24981, KPA24985, KPA24986, KPA24987 dhe KPA24988; me vendimin e vet KPCC/D/R/21/2008 të datës 20 qershor 2008 aprovoi kërkesën në lëndën KPA24980. Kërkesat për kompensim u hodhën poshtë meqë nuk ishin në kompetencën e KKPK-së.

Më vonë njoftimet u kontrolluan bazuar në hartën kadastrale, ortofotot dhe koordinatat GPS. Në lëndët KPA24979 (vendimi KKPK/D/A/19/2008, dosja gjyqësore GSK-KPA-A-096/12) dhe KPA24980 (vendimi KKPK KPCC/D/R/21/2008, dosja gjyqësore GSK-KPA-A-097/12) e vërtetua se njoftimi ishte i saktë. Në lëndët tjera, KKPK shfuqizoi vendimin e vet. Njoftimi u përsërit në vitin 2010 duke e publikuar kërkesën në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së nr.7 dhe në Buletinin e Pronave të Zyrës së UNHCR-së. Publikimet u vendosën në hyrje dhe dalje të Bajqinës si dhe u lanë te kreu i fshatit i cili pranoi që ato t'i lë në dispozicion të palëve të interesuara. Gazeta dhe Buletini u lanë po ashtu te institucionet e ndryshme publike (UNHCR, Ombudspersoni, Gjykata Komunale e Podujevës, etj).

Me vendimin e vet KPCC/D/A/119/2011 të datës 7 shtator 2011, KKPK përsëri pranoi kërkesat për ri-posedim por megjithatë hodhi poshtë kërkesat për kompensim.

Më 7 qershor 2012, H V. (pala ankuese) paraqiti një ankesë kundër vendimeve lidhur me të gjitha tetë lëndët në AKP. Ai deklaroi se pasuria ishte pronë e familjes së tij. Për ta mbështetur këtë pretendim, ai dorëzoi kopjet nga dosja C.Nr. 682/58 e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, lënda e M.G. dhe të tjerëve kundër M. J. dhe të tjerëve që kanë shfrytëzuar pronën e kërkuar. Dosja përmbante një vendim të Gjykatës së Qarkut të Sheriatit në Podujevë të datës 6 korrik 1931, me të cilin një kontest ndërmjet anëtarëve të familjes Veseli dhe anëtarëve të familjes Jovanović rreth disa ngastrave është dërguar në gjykatën e rregullt civile. Për më tepër, dosja përmbante një vendim të Gjykatës së Apelit të Shkupit– Nr. 5384 të datës 27 korrik 1948 – me të cilin ky rast u dërgua prapa në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për rigjykim; procesverbali i lëndës Nr. 682/58 si dhe vet vendimi Nr. G.682/58, të lëshuara më 29 dhjetor 60. Aktgjykimi shpjegon se paraqitësit e kërkesave pretenduan se ata ishin pronarët e pasurive të ndryshme të përshkruara në aktgjykim. Dikur rreth viteve 1912

dhe 1914 kishte pasur bisedime ndërmjet paraardhësve të tyre dhe paraardhësve të palëve përgjegjëse në kërkesa rreth blerjes së disa pronave të përshkruara në vendim. Paraqitësit e kërkesave, megjithatë, deklaruan se pronat nuk ishin shitur asnjëherë dhe se palët përgjegjëse në kërkesë i kishin uzurpuar ato prona. Gjykata e Qarkut refuzoi kërkesën. Gjykata vendosi se palët përgjegjëse në kërkesë ishin pronarët e vërtetë të pronave pasi që paraardhësi i tyre, S. J., i kishte blerë këto prona nga paraardhësi i paraqitësit të kërkesës, V. dhe, përveç tjerash, e kishte shfrytëzuar atë pa ndërprerje që nga viti 1918 (“pas okupimit”), pra më shumë se 40 vite.

Paraqitësi i kërkesës (tani e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) u përgjigj në ankesë, duke cekur se ajo ishte e palejueshme dhe nëse gjykata megjithatë dëshironte t’i përgjigjet ankesës, ajo ishte e pabazuar pasi që vendimi i Gjykatës së Qarkut ishte në dobi të paraardhësve të palës përgjegjëse në ankesë. Për më tepër, paraardhësit e palës përgjegjëse në ankesë dhe ai vetë i kishin pasur në posedim ngastrat deri në vitin 1999, që është pothuajse 40 vite që nga vendimi i Gjykatës së Qarkut.

Gjykata Supreme i ka bashkuar lëndët.

Arsyetimi ligjor:

I. Lënda KPA24979

Ankesa në lëndën KPA24979 është e palejueshme pasi që pala ankuese nuk kishte marrë pjesë në procedurën pranë AKP-së.

Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, një palë mund ta paraqesë ankesën brenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i vendimit. Neni 10.2 i Rregullores parasheh: “*Çdo person, përveç paraqitësit të kërkesës [...] është palë në këtë kërkesë dhe në procedurat e përfaqëta, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive*”.

Në lëndën e tanishme, pala ankuese nuk e ka informuar Sekretarinë ekzekutive rreth qëllimit të tij që të merr pjesë në procedurë. Pala ankuese nuk jep ndonjë shpjegim për këtë lëshim. Sipas nenit

10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079: “*Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës*”.

Prandaj, Gjykata Supreme duhet të vërtetojë nëse pala ankuese është njoftuar me kërkesën. Mënyra e njoftimit për një kërkesë në këtë procedurë parashihet me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite, Sekretaria ekzekutive e njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paraqitësit të kërkesës, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë.

Në rastin konkret, Sekretaria ekzekutive bëri njoftimin rreth kërkesës duke vendosur afishe në ngastër në tetor të vitit 2007. Kjo masë përbën përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar kërkesën në mënyrë të duhur. Për më tepër, asgjë nuk sugjeron se pala ankuese nuk ka mundur të jetë e informuar për njoftimin. Nga të gjitha elementet e cekura më lartë, Gjykata Supreme konsideron se pala ankuese ka pasur rastin të informohet rreth procedurës dhe ta paraqesë mbrojtjen e tij në shkallën e parë. Pasi që ai nuk është përgjigjur në kërkesë brenda afatit dhe meqë ai nuk ishte palë para KKKP-së, atij nuk i lejohet më që të paraqitet para Gjykatës Supreme për paraqitje të ankesës. Rrjedhimisht, ankesa e tij do të hidhet si e palejueshme sipas nenit 13.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (shih po ashtu nenin 196 dhe 195.1 (a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore).

Gjykata dëshiron të shtojë se edhe nëse ankesa do të ishte e pranueshme ajo megjithatë do të ishte e pabazuar pasi që arsyetimi më poshtë – mbi meritat – vlen gjithashtu për këtë lëndë.

II. Lëndët KPA24978, KPA24980, KPA24981, KPA24985, KPA24986, KPA24987 dhe KPA24988

a. Pranueshmëria

Ankesa në këto lëndë është e pranueshme edhe nëse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurë para AKP-së/KKKP-së.

Gjykata vëren se në lëndën KPA24980 (KPCC/D/R/21/2008 i datës 20 qershor 2008)

njoftimi është bërë duke vendosur një shenjë. Njoftimi është kontrolluar dhe pretendohet se ka qenë i saktë, edhe pse shenja nuk ishte vendosur te ngastra por 11 m më tutje. Gjykata nuk pajtohet me mendimin se një shenjë e vendosur 11 metra larg ngastrës së kontestuar mund ta njoftojë saktësisht kërkesën. Personat që kanë uzurpuar ngastrën nuk kanë ndonjë arsye – përveç kureshtjes – të merren me shenja të vendosura 11 m jashtë ngastrës së uzurpuar. Pa njoftim të mirëfilltë, megjithatë, Gjykata nuk mund të supozojë se pala ankuese ka qenë e informuar për kërkesën. Prandaj, fakti se pala ankuese nuk e kishte informuar Sekretarinë ekzekutive rreth qëllimit të tij të merr pjesë në procedurë dhe nuk kishte qenë palë në procedurë nuk mund të përdoret kundër palës ankuese.

Në lëndët tjera, KPA24978, KPA24981, KPA24985, KPA24986, KPA24987 dhe KPA24988 (KPC/D/A/119/2011 i datës 7 shtator 2011), njoftimi është bërë duke publikuar kërkesën në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-së. Kjo, megjithatë, përbën “përpjekje të arsyeshme” sikurse parashihet me nenin 10.1 të rregullores vetëm në raste të veçanta. Një përjashtim i tillë nuk ndodhet në këtë rast. Pasi që Gjykata nuk mund ta përjashtojë faktin se pala ankuese nuk ka qenë e informuar rreth kërkesave, ai duhet të pranohet si palë në procedurë; ankesa e tij është e pranueshme.

Gjykata vendos mbi lëndët pasi që janë siguruar të gjitha informatat e domosdoshme për vendim.

b. Mbi meritat

Ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë, Gjykata nuk ka gjetur vërtetim të paplotë të fakteve dhe as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale apo procedurale.

Gjykata fillimisht dëshiron të theksojë se lënda është nën kompetencën e KKPK-së dhe të Kolegjit të Apelit të AKP-së. Lënda ndërlidhet drejtpërdrejtë me konfliktin e armatosur në Kosovë. Pala përgjegjëse në ankesë thekson se ngastrat kanë qenë në posedimin e tij deri në vitin 1999 dhe ishin humbur vetëm gjatë konfliktit të armatosur. Pala ankuese nuk e konteston këtë por vetëm pretendon prona “ka qenë e jona”.

KKPK ka vlerësuar drejtë faktet dhe ka vendosur se pala përgjegjëse në ankesës kishte dëshmuar se M. J. ishte pronar i pasurisë. Prona është e regjistruar në emër të M.J..

Pala ankuese nuk ka paraqitur prova që mund to çonin në një vendim tjetër. Gjykata ka marrë në konsideratë të gjitha dokumentet e dorëzuara nga paraqitësi i kërkesës. Gjykata fillimisht vëren se ekziston deri diku një mundësi që prona e kontestuar në këtë lëndë para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë së paku përfshin një pjesë të pronës së kontestuar në lëndët këtu. Së paku, asnjë palë nuk e pretendon të kundërtën. Megjithatë, edhe nëse supozojmë se prona është e njëjtë, nuk ka asgjë që do të shpinte në konkludimin ligjor se prona i përkiste familjes së palës ankuese. Vendimet e Gjykatës së Qarkut të Sheriatit në Podujevë të vitit 6 korrik 1931 dhe vendimi i Gjykatës së Apelit në Shkup – Nr. 5384 të datës 27 korrik 1948 – nuk shkojnë në meritat e lëndës. Procesverbalet me deklaratat e dëshmitarëve/palëve nuk vendosin në kontest. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës Nr. G.682/58, i lëshuar më 29 dhjetor 1960, megjithatë, sugjeron krejtësisht të kundërtën e pretendimeve të palës ankuese. Me këtë aktgjykim, Gjykata e Qarkut vendosi se prona nuk i përkiste familjes së palës ankuese por familjes së palës përgjegjëse në ankesë, Jovanović.

Regjistri i dosjes së lëndës, megjithatë, tregon se ka pasur një ankesë ndaj këtij aktgjykimi, një vendim lidhur me ankesën dhe me sa duket një rishikim. Pala ankuese, megjithatë, nuk i ka dorëzuar këto vendime në Gjykatë. Ai gjithashtu ka qenë i informuar rreth faktit se këto nuk ishin paraqitur pasi që ai nënshkroi një listë të dokumenteve të dorëzuara e cila nuk përmban këto aktgjykime, ndërsa përmban vendimin e Gjykatës së Qarkut. Prandaj, nuk ka qenë e domosdoshme për Gjykatën që ta informojë palën ankuese se këto vendime nuk ishin përfshirë. Gjykata po ashtu nuk sheh ndonjë arsye që t'i kërkojë këto vendime ex officio pasi që duhet të supozojë se regjistrimi i ngastrave do të ishte në emër të një anëtari të familjes së palës ankuese nëse vendimet do të kishin qenë në dobi të familjes së tij. Gjithashtu, ngastrat do të ishin në posedim të familjes së palës ankuese pas aktgjykimit përfundimtar. Megjithatë, pala ankuese nuk pretendon se ngastrat kanë qenë ndonjëherë në posedim të familjes mes viteve 1920 dhe 1999, ai vetëm deklaroi se familja e tij i zotëron ato dhe si dëshmi jep se të dyja familjet kishin një kontest rreth pronës (që mund të përfshinte këto ngastra) gjatë viteve 1960.

Pas gjithë kësaj, Gjykata nuk gjen se pala ankuese ka pasur sukses në lëkundjen e provave të cilat e sugjeronin të atin e palës përgjegjëse në ankesë si pronar i pasurive.

Gjykata dëshiron të shtojë se me vendimin e Gjykatës së Qarkut të datës 29 dhjetor 1960, prona është dhënë në posedim të familjes së palës përgjegjëse në ankesë – vendimi madje thotë se prona ka qenë në posedim të familjes së palës përgjegjëse në ankesë që nga viti 1914

me një ndërprerje vetëm gjatë okupimit në Luftën e Parë Botërore, ku gjatë asaj kohe është përdorur nga familja e palës ankuese. Sikurse parashihet me nenin 28.4 të Ligjit Mbi Marrëdhënjet Themelore Pronësore-Jurdike (GZ e RSFJ-ës, No. 6/80) mbajtësi me mirëbesim fiton të drejtën e pronës pas njëzet vitesh, babai i ankuesit – madje edhe pa vendimin e Gjykatës, do të fitonte të drejtën e pronësisë përmes parashkrimit fitues (nga ai vet dhe me gjasë nga pasardhësit e tij ligjor). Kjo edhe sipas nenit 40.1 të Ligjit Mbi Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore (GZ e Republikës së Kosovës e datës 4 gusht 2009), që parasheh: *“poseduesi me mirëbesim e fiton të drejtën e pronësisë në një palujtshmëri, osë në një pjesë të saj, pas njëzet (2) vitesh të posedimit të pandërprerë”*.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10,11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10,21, 10,12 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të përlllogaritet të jetë mbi € 4.500: € 25.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 45, paragrafi 1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave është 15 ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it